



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 13.01.2026

Numër Protokolli: 327/2026

A.nr.1897/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1897/2025, të datës 12.11.2025, të parashtruar nga ankuesja A.J nga Podujeva, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*transferim sipas rristrukurimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1897/2025, e datës 12.11.2025 e parashtruar nga ankuesja A.J.

II. Anulohet Vendimi Nr.R.MBPZHR 31/2025 i datës 31.10.2025 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe **Anulohet** numri **Rendor 98** i përfshirë në pjesën “**Bartësi i Pozitës së Ndryshuar dhe Shuar sipas Riorganizimit të Ri**”, të Raportit të Rristrukurimit të datës 30.10.2024, lidhur me propozimin për transferimin e ankueses nga pozita “Zyrtar i Lartë për Pesticide” në pozitën “Zyrtar i Lartë i Blegtorisë”, ndërsa lënda kthehet **në rishqyrtim** dhe **rivendosje** te organi i njëjtë (Komisioni i Rristrukurimit në MBPZHR) vetëm për rastin e ankueses.

III. Obligohet Komisioni i Rristrukurimit për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në piken **II** të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Ar sy e t i m

Ankuesja A.J (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja) më datë 12.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.R.MBPZhR 31/2025, të datës 31.10.2025 të Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me transferimin e saj për shkak të ristrukturimit të organit të punësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 21.11.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (tutje MBPZhR), ndërsa, kjo e fundit, më datë 25.11.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 23.12.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:8049/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1897/2025 të datës 12.11.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7329/2025 të datës 12.11.2025 të ankuesit drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:8049/2025 të datës 23.12.2025; Vendimin Nr.R.MBPZhR 31/2025, të datës 31.10.2025 të Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Kërkesën e datës 14.07.2025; Akt Emërimitin e datës 23.12.2024; Diplomën e ankueses Nr.276 të datës 10.09.2019; Diplomën e ankueses Nr.466 të datës 18.09.2015; Letë referencë e datës 29.02.2025 lëshuar nga AZHB; kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 21.11.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 25.11.2025; Organogrami i Strukturës Organizative të MBPZHR-së; Vendimin e datës 04.07.2025 të Drejtorit të DMZP-së; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë për pesticide; Konkursin e datës 29.08.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë i blegtorisë; Shkresë e datës 17.06.2025 dërguar nga J.R për F.M me korrespondencën e bashkangjitur; Vërtetimin e datës 16.12.2026 lëshuar nga Komuna e Podujevës; Raporti përfundimtar i Komisionit të Ristrukturimit i datës 30.10.2025; Kërkesë e datës 14.07.2025 e ankueses; E-mailin e datës 23.07.2025 dërguar nga V.Ç për F.M me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; E-mailin e datës 29.07.2025 dërguar nga Q.B për F.M me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e parashtruara të lëndës nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses e është **e bazuar**, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesja sipas Aktit të Emërimit Nr.13/2024 të datës 23.12.2024 është e punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pozitën “Zyrtar i Lartë për Pesticide”.

Tutje, përmes Vendimit Nr.226/ 2025, të datës 05.03.2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) nr.01/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të

Punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me ç'rast procesi i organizmit të MBPZHR, është pasuar me shuarje të pozitive, ndryshime në emërtime të pozitive përkatëse, ndryshim të klasave të pozitive, si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kriterëve të punës për pozita të caktuara. Bazuar në legjislacionin në fuqi, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me numër V.nr. 1478/2025, të datës 04.07.2025, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për MBPZHR, ku ky i fundit, më datë 30.10.2025, ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në MBPZHR.

Sipas Raportit përfundimtar Nr.3412 të datës 30.10.2025, të Komisioni i Ristrukturimit, në pjesën e titulluar “Bartësi i pozitës së ndryshuar dhe shuar sipas organogramit të ri”, nën numri rendor 98, ankuesja nga pozita “Zyrtar i Lartë për Pesticide”-Klasa Profesional 1, në kuadër të Divizionit të Mbrojtjes së Bimëve, është rekomanduar të transferohet në pozitën “Zyrtar i Lartë i Blegtorisë”-Klasa Profesional 1, në kuadër të Divizionit për Prodhimtari Blegtorale, me arsyetimin se pozita të cilën e ka mbajtur ankuesja “Zyrtar i Lartë për Pesticide” është kategorizuar “Specialist”, ndërsa kjo e fundit nuk i plotëson kriter për këtë pozitë, mirëpo pa përcaktuar se cilat janë kriteret për pozitën përkatëse dhe cilin kriter saktësisht nuk e ka plotësuar, nëse bëhet fjalë për kriterit arsimor, kriterin e përvojës së punës apo nëse pozita në fjalë ka të aprovuar edhe kriteret specifike.

Me qëllim të zbatimit të propozimi të Komisionit të Ristrukturimit, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 31.10.2025, ka nxjerr Vendim me Nr.R.MBPZHR 31/2025, me të cilin ankuesen e ka transferuar nga pozita Zyrtar i Lartë për Pesticide në pozitën Zyrtar i Lartë i Blegtorisë, kurse ankuesja ndaj këtij vendimi me datë 12.11.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill.

Në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesja pretendon se në rrethanat e rastit konkret nuk është plotësuar parakushti ligjor për transferimin e saj, ngase sipas 66 të LZP-së, transferimi për shkak të ristrukturimit ndodh vetëm në rastin kur shuhet pozita ndërsa pozita që kam mbajtur me akt emërim, Zyrtar i Lartë për Pesticide nuk është shuar dhe vazhdon të ekzistojë si pozitë në kuadër të Kategorisë Specialist, madje e njëjta thekson se organit të punësimit i është drejtuar me kërkesë (14.07.2025) për klasifikimin e pozitës së saj, po ashti e njëjta pretendon se për pozitën në të cilën është transferuar Zyrtar i Lartë i Blegtorisë nuk i plotëson kriteret pasi që nuk është e kualifikuar në fushën e blegtorisë, por e njëjta e ka programi e kualifikimit për pozitën që ka mbajtur më kat emërim, sikurse përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Pesticide mbetet i njëjtë veçse kategoria i ka ndërruar pozitës, dhe po ashtu ankuesja pretendon se në rastin e konkret me transferimin e saj është shkelur edhe nenin 13 paragrafi 7 të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, sikurse vendimi apo rekomandimi për transferimin tim nuk janë arsyetuar sipas ligjit, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e saj, të anuloi aktin e kontestuar dhe kthimi i ankueses në pozitën e saj Zyrtar i Lartë për Pesticide të cilën e mban sipas aktit të emërimit.

Kolegji i Këshilli me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, fillimisht analizoi dhe mori për bazë kuadrit ligjor në fuqi nga neni 66 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2.*

në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunës/e civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunës/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsyt e parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës”..... dhe si rrjedhojë bazuar në frymën e këtyre normave juridike, Kolegji i Këshillit vlerëson se ristrukturimi është proces i ndryshimit të organizmit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe fushëveprimit të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit mund të ketë ndryshime të vendeve të punës, shkurtime (shuarje) të vendeve të punës apo ndryshime të kriterëve të vendeve të punës, duke përfshirë edhe klasifikimin e pozitave përkatëse sipas përcaktime ligjore në fuqi.

Kolegji po ashtu, analizoi edhe strukturën e re organizative të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të miratuar sipas Rregullores (ZKM) nr.01/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, ashtu që u konstatoi se pozita Zyrtar i Lartë për Pesticide të cilën ankuesja e ka mbajtur sipas aktit të emërimit nuk është shuar, gjegjësisht pozita në fjalë me rregulloren e re është klasifikuar në Kategorinë Specialist, dhe figuron në kuadër të Divizionit për Mbrojtjen e Bimëve dhe Shëndetit Bimor/Departamenti për Politika Bujqësore.

Po ashtu, Kolegji mori përbazë edhe dispozitat e aplikuara nga Rregullorja Nr.06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, shtojca Nr.1/4: Përkthimi i përgjithshëm i punës për klasën Specialist, ku përcaktohet se Kërkesat e përgjithshme formale janë : **“a) Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushat e inxhinierisë, planifikim hapësinor, arkitekturë, urbanizëm, gjeodezi, kimi, fizikë, matematikë, biologji, mjekësi, farmaci, biokimi, ekologji, pylltari, **bujqësi, veterinar**, gjeografi, ambient, astronomi, astrofizikë, pa përfshirë drejtimet arsimore. **b) Kërkesat specifike:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. **c) Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku **tre (3) vite** përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës”, ndërsa nga administrimi provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, respektivisht provat e ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit, Kolegji Konstatoi se ankuesja posedon Diplomën me shifër Nr.466 të datës 18.09.2015 përmes së cilës konfirmohet fakti se e ankuesja me datë 14.09.2015 ka mbaruar Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtinë”, kurse lidhur me përvojën e punës e njëjta në bazë të provave të lëndës ka mbi tre (3) vite përvojë të punës pas diplomimit, ashtu që vetëm sipas Letër referencës Nr.1070 të datës 29.02.2024 të lëshuar nga Drejtori Ekzekutiv i AZHB-së, e njëjta ka qenë e angazhuar në këtë institucion në periudhës kohore prej tre (3) vitesh dhe atë që nga muaji mars 2021 e deri në muajin mars 2024, gjithashtu sipas Vërtetimit Nr.13-387 të datës 16.12.2016 të lëshuar

nga Njësia e Personelit në Komunën e Podujevës dëshmohej fakti se ankuesja nga data 01.11.2016 e deri me datë 16.12.2016 ka kryer praktiken profesionale në këtë institucion, po ashtu e njëjta ka edhe dëshmi të tjera të kontratave të punës me Care International Kosova të periudhës kohore pas diplomimit dhe atë në fushën e agrokulturës, duke shtuar këtu edhe Akt Emërimit të datës 23.12.2024, arrihet në konstatimin se e njëjta i ka mbi tre (3) vite të përvojës së punës profesionale në fushën përkatëse.

Thënë si më lartë, pas analizimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses si dhe pas analizimit dhe marrjes për bazë të kuadrit ligjor në fuqi, Kolegji i Këshillit erdhi në konstatimin se organi i punësimit respektivisht Komisioni i Ristrukturimit fillimisht ka zbatuar gabimisht dispozitat e aplikuara nga nenin 66 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“66.1 Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.”*, kurse në rrethanat e rastit konkret pozita e ankueses Zyrtar i Lartë për Pesticide nuk është shuar ngase është e parashikuar edhe me rregulloren e të organit të punësimit, Rregullores (ZKM) nr.01/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me Organogramin e bashkangjitur, mirëpo pozita në fjalë është klasifikuar në Kategorinë Specialist në frymën e nenit 27 paragrafi 1 të Rregullorja Nr.06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: *“Klasa të cilës i përket secila pozitë konkrete e kategorisë së specialistëve dhe profesionale, përcaktohet dhe miratohet njëkohësisht me Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Institucionit.”*, ndërlidhur me Shtojcën Nr.1/4: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Specialist, ku përcaktohen kërkesat e përgjithshme formale lidhur me kualifikimin arsimor dhe përvojën e punës të evidentuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi.

Prandaj, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit mbetet e paqartë se mbi bazën e cilave provave materiale apo mbi bazën e cilave dispozitave ligjore Komisioni i Ristrukturimit për MBPZHR-në, ka ardhur në konstatimin se ankuesja nuk i plotëson kriteret përkatëse për pozitën të cilën e ka mbajtur sipas akt emërimit, madje arsyetimi i dhënë në Raportin përfundimtar Nr.3412 të datës 30.10.2025 lidhur me transferimin e ankueses është i paqartë, jo bindës dhe është abstrakt, madje në arsyetimin e dhënë as nuk përcaktohet se cilat janë kriteret e përcaktuara për pozitën Zyrtar i Lartë për Pesticide, e cila pas hyrjes në fuqi të rregullores së re është klasifikuar në Kategorinë e Specialistëve si pozitë, por pa i ndryshuar qëllimi i vendit të punës, andaj duke marrë për bazë konstatimet e dhënë si në arsyetimin e këtij vendimi me qëllim të kthimit të ligjshmërisë në vend, Kolegji i këshillit duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara të ligjit material dhe dispozitave të LPPA-së, konstatoi se Komisioni në fjalë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”*, dhe si rrjedhojë pika me numrin rendor 98 në pjesën e titulluar **“Bartësi i pozitës së ndryshuar dhe shuar sipas organogramit të ri”**, në kuadër të Raportit përfundimtar Nr.3412 të datës 30.10.2025, të Komisioni i Ristrukturimit është e paligjshme dhe vendosi që të njëjtën të anuloi si në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa ankesën e ankueses të aprovoi si të bazuar në ligj.

Për rrjedhojë duke marrë për bazë dispozitat e nenit 13 paragrafi 5, 6 dhe 7 të Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ku Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë,

përmes Vendimit të datës 31.10.2025 më shifër Nr.R.MBPZHR 31/2025 e ka transferuar ankuesin në pozitën “Zyrtar i Lartë i Blegtorisë” në Divizionin për Prodhimtari Blegtorale, është akt i paligjshëm pasi që është mbështetur mbi propozimin e Komisionit të Ristrukturimit sipas Raportit të Ristrukturimit të datës 30.10.2025, ashtu që pika përmes të cilës është propozuar transferimi i ankueses është konstatuar se është në kundërshtim me ligjin material dhe si rrjedhojë duke u mbështet në dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që Vendimi i datës 31.10.2025 më shifër Nr.R.MBPZHR 31/2025 të anulohet sikurse në dispozitivin e këtij vendimi sikurse edhe pika e kontestuar e raportit anulohet po ashtu, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik duhet të nxjerr vendim të ri për ri caktimin e ankueses në pozitën të cilën do të propozojë Komisioni i Ristrukturimit pas plotësimit ndryshimit të Raportit të datës 30.10.2025 sipas pikëpamjeve juridike të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, ashtu që Komisioni i Ristrukturimit me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankueses duhet të marrë përbazë pikëpamjet dhëna juridike si në arsyetimin e këtij vendimi si dhe praktikës vendimmarrëse për rastet e ngjashme si në raportin përkatës të punës/Raporti përfundimtar i datës 30.10.2025, prandaj nisur nga ky fakt meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi shkelje esenciale të dispozitave të nenit 66 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me nenin 8 paragrafi 1 të të njëjtit ligj, vendosi si në diapozitivin e vendimit me qëllim të anulimit të aktit që ka prodhuar efekte juridike për palën, dhe lëndën e kthej në rishqyrtim për të mënjeluar këto të gjetura tek organi përkatës, gjegjësisht anulimi i aktit të ankimuar i eliminon edhe efektet e tjera për të cilat pala pretendon se kanë cenuar të drejtat e tij.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1897/2025, datë 13/01/2026

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses A.J;
- Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (*Komisionit të Ristrukturimit dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore*)
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.